



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 657/3 prot.

Elbasan, më 17.7.2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.57 dt.24.06.2025 “Për shpërblim në natyrë të shpronësimit për interes publik”, si dhe pasi u njohëm me të dhënat plotësuese, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 639/ prot.

Elbasan, më 17.2025

**Lënda:** Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, përpara se të shprehemi për ligjshmërinë e aktit tuaj nr.57 dt.24.06.2025 “Për shpërblimin në natyrë të shpronësimit për interes publik“, kërkojmë të dhëna sqaruese si më poshtë:

- Referuar VKM-së nr.797 datë 28.12.2023 “Për përcaktimin e rasteve dhe të rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik”, neni 4 pika 2), a ka paraqitur kërkesë për shpërblim në natyrë, subjekti që kërkohet të shpronësohet? Nëse po të na përcillet një kopje e kërkesës.
- Në rast se procedura e shpronësimit nuk përfshihet në rastet që mund të kualifikohet për shpërblim në natyrë, si është parashikuar të procedohet më tej nga ana juaj?

Deri në dërgimin e të dhënave akti juaj mbetet i pakonfirmuar.

**PREFEKTI**



**Ilir BEJTJA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 699  
dt. 27.6.2025



**VENDIM**

**Datë.26.06.2025**

Nr. 4461 prot

**Nr.57 dt.24.06.2025**

**“PËR SHPËRBLIM NË NATYRË TË SHPRONSIMIT PËR INTERES PUBLIK”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”,nenit 54 “Për detyrat dhe kopetncat e Keshillit Bashkiak”,VKM-së nr.797 datë 28.12.2023 “ Për përcaktimin e rasteve dhe të rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronsimeve për interes publik,Këshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 24.06.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kërkesës për shpërblimin në natyrë në favor të shtetasit Eduart Buzra , fshati Gizavesh, Njësia Administrative Qendër , për një sipërfaqe 116 m<sup>2</sup> tokë bujqësore arë në të cilën është bërë zgjerimi i rrugës .
2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Planifikimit , Kontrollit të Territorit dhe Pronës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes .

SEKRETAR I KËSHILLIT  
**Elson MALLUTA**

KRYETARI I KËSHILLIT  
**Mitat BICAKU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LIBRAZHD  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK , BUJQËSISË DHE TURIZMIT  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE

RELACION

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Nenit 54 “Për detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, VKM – së nr.797 datë 28.12.2023 “ Për përcaktimin e rasteve dhe të rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik “, kërkohet miratimi i kërkesës për shpërblimin në natyrë në favor të shtetasit Eduart Buzra , fshati Gizavesh , Njësia Administrative Qendër .

Shtetasi Eduart Buzra disponon certifikatë pronësie për pasurinë nr.177/5 e llojit arë me sipërfaqe 2717.5 m<sup>2</sup> . Kjo pasuri është prekur nga zgjerimi i rrugës në fshatin Gizavesh . Ky shpërblim në natyrë do të kryhet për një sipërfaqe 116 m<sup>2</sup> tokë bujqësore arë në të cilën është bërë zgjerimi i rrugës së lagjes në këtë fshat .

Kjo sipërfaqe e zënë nga zgjerimi i kësaj rruge u evidentua në terren nga grupi i punës së ngritur për këtë qëllim sipas urdhërit nr.407 datë 19.05.2025 me nr.prot.3588 datë 19.05.2025.

Shpërblimi në natyrë i shpronësimit për interes publik do të realizohet sipas nenit 4 , pika 2 dhe 3 e VKM – së nr.797 datë 28.12.2023 ku Agjencia Shtetërore për Shpronësim do të ndjekë procedurën e mëtejshme .

Duke qenë se pasuria që shpronësohet është tokë bujqësore atëherë edhe shpërblimi në natyrë do të bëhet me tokë bujqësore pronë shtetërore , siç parashikon VKM si më sipër .

Me qëllim të zgjidhjes ligjore të këtij problemi i paraqesim këtij këshilli këtë projekt vendim .

Bashkëngjitur këtij relacioni plan rilevimi i hartuar për sipërfaqen e zënë nga zgjerimi i rrugës .

Konceptoi :

E . Gjura

Xh.Bozhiqi

R. Alla

Urbanistika  
dt. 16.05.2025

3584  
Dt 16.05.2025

## Kërkesë

Drejtuar: Bashkia Librazhd

### LËNDA:

Kërkesë për kompensim/shpërblim në natyrë për zënien e një pjese toke me rastin e zgjerimit dhe shtrimit të rrugës së lagjes Gizavesh.

Të nderuar,

Në cilësinë e pronarit të pasurisë me:

- **Nr. pasurie:** 177/5
- **Lloji:** Arë
- **Sipërfaqe:** 2,717.5 m<sup>2</sup>
- **Vendndodhja:** Fshatin Gizavesh, njësinë administrative Qender, Bashkia Librazhd

Ju parashtroj këtë **kërkesë për verifikimin në terren dhe për kompensim në natyrë** për shkak se një pjesë e kësaj prone është zënë dhe përfshirë në mënyrë faktike nga zgjerimi dhe sistemimi i rrugës ekzistuese të lagjes Gizavesh. Në kushtet kur pasuria ka pësuar ndërhyrje të konsiderueshme për interes publik, kërkoj nga ana juaj:

- **Kompensimin ose shpërblimin në natyrë** për pjesën e zënë nga rruga, në përputhje me legjislacionin në fuqi

Ju lutem që kjo kërkesë të shqyrtohet në mënyrë të drejtë dhe të më jepet përgjigje brenda afatit ligjor. Bashkëngjitur paraqes:

- Kopje të **çertifikatës së pronësisë**;

Jam në pritje të përgjigjes tuaj!

Faleminderit!

Eduart Buzra

Përfaqësuar nga:

Halit Buzra



Librazhd me \_\_\_/\_\_\_/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 4745 Prot.

Librazhd, 09.07.2025

LËNDA : **Kthim përgjigje**

DREJTUAR : **Prefekti I Qarkut Elbasan  
Sektori I Zhvillimit Urban**

**ELBASAN**

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.699/1 prot, date 01.07.2025, ku kërkon të dhëna sqaruese në lidhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak Librazhd nr. 57 date 24.06.2025 “ Për shpërblimin në natyrë të shpronsimit për Interes Publik”.

- Në lidhje me pikën e parë po ju dërgojmë dhe një kopje të kërkesës që subjekti kërkon të shpronësohet në natyrë.
- Në lidhje me pikën e dytë, duke ju referuar dhe kërkesë ku vetë subjekti kërkon shpërblim në natyrë dhe jo shpronsim të tokës . Pasi të jë konfirmuar akti nga Prefekti I Qarkut Proçedurat e mëtejshme do të ndiqen pranë ASHSH (Agjencisë Shtetërore për Shpronsim).

Duke Ju falenderuar për mirkuptimin,

**SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**ELSON MALLUTA**

Adresa :Sheshi “ GjorgGolemi”, Librazhd [www.bashkialibrazhd.gov.al](http://www.bashkialibrazhd.gov.al)

[info@bashkialibrazhd.gov](mailto:info@bashkialibrazhd.gov)

Urbanistika

dt. 16.05.2025

3584

Dt 16.05.2025

## Kërkesë

Drejtuar: Bashkia Librazhd

### LËNDA:

Kërkesë për kompensim/shpërblim në natyrë për zënien e një pjese toke me rastin e zgjerimit dhe shtrimit të rrugës së lagjes Gizavesh.

Të nderuar,

Në cilësinë e pronarit të pasurisë me:

- **Nr. pasurie:** 177/5
- **Lloji:** Arë
- **Sipërfaqe:** 2,717.5 m<sup>2</sup>
- **Vendndodhja:** Fshatin Gizavesh, njësinë administrative Qender, Bashkia Librazhd

Ju parashtroj këtë **kërkesë për verifikimin në terren dhe për kompensim në natyrë** për shkak se një pjesë e kësaj prone është zënë dhe përfshirë në mënyrë faktike nga zgjerimi dhe sistemimi i rrugës ekzistuese të lagjes Gizavesh. Në kushtet kur pasuria ka pësuar ndërhyrje të konsiderueshme për interes publik, kërkoj nga ana juaj:

- **Kompensimin ose shpërblimin në natyrë** për pjesën e zënë nga rruga, në përputhje me legjislacionin në fuqi

Ju lutem që kjo kërkesë të shqyrtohet në mënyrë të drejtë dhe të më jepet përgjigje brenda afatit ligjor. Bashkëngjitur paraqes:

- Kopje të **çertifikatës së pronësisë**;


Jam ne pritje te përgjigjes tuaj!

Faleminderit!

Eduart Buzra

Përfaqesuar nga:

Halit Buzra



Librazhd me \_\_\_/\_\_\_/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 039/ prot.

Elbasan, më 17.2025

**Lënda:** Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, përpara se të shprehemi për ligjshmërinë e aktit tuaj nr.57 dt.24.06.2025 “Për shpërblimin në natyrë të shpronësimit për interes publik“, kërkojmë të dhëna sqaruese si më poshtë:

- Referuar VKM-së nr.797 datë 28.12.2023 “Për përcaktimin e rasteve dhe të rregullave për shpërblimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik”, neni 4 pika 2), a ka paraqitur kërkesë për shpërblim në natyrë, subjekti që kërkohet të shpronësohet? Nëse po të na përcillet një kopje e kërkesës.
- Në rast se procedura e shpronësimit nuk përfshihet në rastet që mund të kualifikohet për shpërblim në natyrë, si është parashikuar të procedohet më tej nga ana juaj?

Deri në dërgimin e të dhënave akti juaj mbetet i pakonfirmuar.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

